



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-026

Prishtinë, më 19 korrik 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 19 KORRIK 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Sasha Milosavleviq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Bilall Sherifi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 korrik 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 12 korrik 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 12 korrik 2011.

2. Plotësimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, që do të mbahet më 21 korrik 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me përgatitjet e bëra, vendosi që rendi i ditës për mbledhjen plenare, më 21 korrik 2011, të plotësohet edhe me këto pika:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 3/L- 010 për noterinë, dhe
2. Njoftimi me vendimi e Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e kryetarit të këtij grupi parlamentare dhe të kryetarit të Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Njoftimi i deputetit Vesimir Saviq për dalje nga Grupit Parlamentar i SLS-së

Kryesia u njoftua për daljen e deputetit Saviq nga Grupi Parlamentar i SLS-së. Ndërsa, lidhur me aktivitetet e tij parlamentare të mëtejme, se cilit grup parlamentar dëshiron t'i bashkëngjitet apo dëshiron të veprojë si deputet i pavarur, duhet ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit.

3.2 Njoftimi i Partisë së Pavarur Liberale lidhur me vendimin për zëvendësimin e kryetarit të Grupit Parlamentar SLS dhe kryetarit të Komisionit për Kthim dhe Komunitete

Kryesia u njoftua me vendimin e Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e kryetarit të këtij grupi dhe të Komisionit për të Drejta dhe Interesat Komuniteteve dhe Kthim. Ky vendim duhet të procedohet në mbledhje plenare më 21 korrik 2011.

3.3 Informata e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për vizitën e realizuar në Gjenevë dhe Bernë

Kryesia u njoftua për vizitën studimore të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, të realizuar në Gjenevë dhe Bernë të Zvicrës, prej 27 deri më 30 qershor 2011.

Të ndryshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit për nevojën e procedimit të projektligjeve, që parashihen me Strategjinë legjislative dhe me Raportin e progresit, para 1 shtatorit 2011. Komisionet parlamentare, që janë të ngarkuara për shqyrtimin e tyre, duhet që këto projektligje t'i shqyrtojnë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime, për miratim në pjesën e fundit të muajit gusht 2011.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e ngritur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një Informatë se cilat projektligje janë në procedurë të shqyrtimit dhe cilat komisione parlamentare janë të ngarkuara për shqyrtimin e tyre. Kryesia e Kuvendit, në bazë të kësaj informate, në mbledhjen e radhës do të vendos për pushimet vjetore të deputetëve dhe të stafit të Administratës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.